



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PERGJITHSHME E PUNEVE PUBLIKE, HARTIMIT TE PROJEKTEVE E INFRASTRUKTURES

RELACION

Per Objektin “Blerje malli per rikonstrukcion rruge dhe sheshe te Bashkise Fier”

Qëllimi:

Mirembajtje e rrugeve, segmenteve rrugore, shesheve ne Bashkine Fier, perfshire punimet e shtresave dhe nenshtresave dhe zevendesimi i atyre te demtuara konform specifikimeve teknike, kushteve teknike të zbatimit, legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e punonjësve, të ambientit dhe publikut, si dhe detyrimeve që lindin dhe që duhet të plotësohen gjatë zbatimit të punimeve lidhur me koordinimin e punes me Ndermarrjen e Sherbimeve Publike te Bashkise Fier.

Shpërndarja e materialeve do te behet sipas evidences se rrugeve dhe shesheve te parashikuara per rikonstrukcion, e hartuar bazuar ne kerkesat e Njesive Administrative te Bashkise Fier dhe verifikimeve te kryera ne vend.

Punimet per shtresat e rrugeve:

Shtresa e çakullit përdoret për nivelimin e terrenit nën trasenë e K.U.Z dhe K.U.B dhe shtrohet mbi terrenin natyral të ngjeshur përpara, në kuotën e percaktuar nga projekti dhe i bëhet ngjeshja me rul. Shtresa e çakullit te minave eshte parashikuar te behet me çakull natyral te nxjerre nga karierat e gurit me shperthime minash ose material tjetër guror dhe i perzier me fraksione deri ne 65 mm që ploteson kerkesat e dhena ne specifikimet teknike te materialeve.

Shtresat e stabilizantit do te hidhet mbi shtresën e zhavorit të ngjeshur mirë dhe me pjerrësinë e dhënë sipas projektit, laget e ngjishet me rul rulvibrues me peshe 10 - 12 ton duke bere 12 kalime ne nje vend. Stabilizanti eshte parashikuar te prodhohet me material gurore te thyer ose zhavor lumi te thyer, te fraksionuar që ploteson kerkesat e dhena ne specifikimet teknike te materialeve.

Sperkatje sipërfaqe me bitum 0.5 l/m² do te behet pas ngjeshjes së stabilizantit duke lagur sipërfaqen me bitum 0.5 l/m², me pikë zbutjeje 40-47°C dhe me penetrim 80-100 mm, mbi të cilën pastaj nuk lejohet të kalojnë mjete ose duhet të mbrohet me mbulimin me një shtresë me granil 1 cm që duhet të rulohet me 4 kalime me rul 10-12 ton.

Shtresë binderi dhe asfaltobetoni: Shtrimi i konglomerateve bituminoze do të bëhet nëpërmjet makinerive asfalto-shtruese me vibrim (vibrofinitrice) në gjendje perfekte pune dhe të përshtatura me pajisje automatike për auto-nivelizim. Asfaltoshtrueset me vibrim duhet të lenë pas një shtresë të mbaruar në mënyrë perfekte, do të thotë pa sgranime të inerteve, plasaritje dhe difekte të ndodhura si pasojë e segregimit të elementeve litoide më të mëdhenj. Gjate shtrimit duhet treguar kujdes maksimal në formimin e bashkimeve (xhuntove) gjatësore, që zakonisht evitohen nëse shtrojmë njëkohësisht “fashion” tjetër të asfaltit pranë asaj të sapo shtruar. Bashkimet tërthore që rrjedhin nga ndërprerja e punimeve duhet të realizohen gjithmonë pasi të jenë prerë dhe të jenë hequr pjesët fundore të fashos. Transporti i konglomerateve nga impianti i

prodhimit në kantier duhet të bëhet me anë të mjeteve të përshtatshme transporti në peshë, eficiente, të shpejtë dhe të pajisur me mbulesë për të evituar ftohjen në sipërfaqe dhe krijimin e koreve në material. Koha më e përshtatshme për shtrimin e asfaltobetonit është stina e pranverës, verës dhe vjeshtës. Megjithatë, në ditët me reshje shiu nuk lejohet. Trashësia e shtresës së asfaltobetonit në momentin e shtrimit (në gjendje të shkrifët) duhet të jetë 1.20 deri 1.25% më shumë nga trashësia e dhënë në projektin e zbatimit në gjendje të ngjeshur.

Specifikimet teknike të materialeve:

-Kerkoheq qe asfalti (tapeti) te jete prodhuar nga material i thyer guri me permasa nga 0-10 mm sipas standarteve perkatese (SSH660-87) me permbajtje bitumi jo me pak se 5 % (SSH561/87). Densiteti 2.3gr/cm³. Bitum 50 70.

-Kerkoheq qe binderi te jete i prodhuar nga material i thyer guri me permasa nga 5-20mm sipas standarteve perkatese (SSH660-87) me permbajtje bitumi jo me pak se 4.5% (SSH561/87). Densiteti 2.2 gr/cm³. Bitum 50 70.

-Kerkoheq qe konglomerati bituminoz te jete prodhuar nga material i thyer guri me permasat nga 5-40 mm sipas standarteve perkatese (SSH660-87) me permbajtje bitum.

-Stabilizanti kerkoheq qe te jete prodhuar me material guri te thyer fraksionar dhe i perzier me perqindje si me poshte:

Gur i bluar (0-5mm) 33%

Gur i bluar (5-20mm) 33%

Gur i bluar (15-30mm) 33%

-Çakulli kerkoheq qe te jete prodhuar me material guri te thyer me makineri dhe i perzier ne fraksione deri ne 65mm, shoqeruar dhe me flete analize e stabilizantit me nje perskrim te karakteristikeve te stabilizantit dhe çakullit qe ofron.

Ing.G. Plesati

Ing.S.Basha

Ing.S.Krasniqi